

VENDIM
Nr. 293, datë 8.4.2015

**PËR MIRATIMIN E LLOJEVE TË ARMATIMIT, TË LËNDËVE
NEUROPARALIZUESE DHE TË MJETEVE TË TJERA TË PËRDORIMIT TË
FORCËS NGA POLICIA E SHETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 99, të ligjit nr. 108/2014, datë 31.7.2014, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e llojeve të armatimit, lëndëve neuroparalizuese dhe mjeteve të tjera të përdorimit të forcës nga strukturat e Policisë së Shtetit, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Tabela organike e pajisjes me armatim, lëndë neuroparalizuese dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës miratohet me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, me propozimin e drejtorit të Policisë së Shtetit.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja

**Llojet e armatimit, municionit, lëndëve neuroparalizuese dhe mjeteve të
tjera të përdorimit të forcës nga Policia e Shtetit**

Strukturat e Policisë së Shtetit në funksion të zgjidhjes së detyrave, pajisen me armatim, municion, lëndë neuroparalizuese dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës, sipas kësaj lidhje:

1. Armatim:

1.1. Armë zjarri të shkurtra:

- a) Pistoletë 9x19 mm.

1.2. Armë të gjata:

- a) Pushkë gjysmë automatike kalibër 5.56 mm deri 9x19 mm.
- b) Automatik kalibër 5.56 x 45 mm NATO deri 9x19 mm;
- c) Pushkë me përpikëri të lartë gjysmë automatike kalibër 5.56x45 mm deri tek 12.7x 99 mm;
- ç) Shotgun kalibër 12 Ga;
- d) Shotgun lëshues kalibër 37/38x40 Ga;
- dh) Armë me veprim elektromuskular;
- e) Armë antitanke një përdorimshe.
- ë) Armë të ftohta

2. Municion:

- a) Municione për armët e shkurtra e të gjata sipas kalibrave përkatës me të gjitha llojet e cilësisë së veprimit;
 - b) Municione me lëndë irrituese në formë pluhuri, lëngu me përbërje CS; CN; OC; që hidhen me shotgun, me granatë dore, pajisje hedhëse, sprajt ose tubet, për mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e turmave;
 - c) Municione që hidhen me shotgun me saçme: gome, metalike, sintetike;
 - ç) Granata akustike dhe verbuese;
-

d) Lëndë plasëse për shpërthim dyersh.

3. Pajisjet e mbrojtjes dhe përdorimit të forcës personale e kolektive:

- a) Jelek antiplumb niveli i III, IIIA, IV;
- b) Kaska antiplumb me pajisje komunikimi dhe pa pajisje komunikimi;
- c) Mburoja individuale, kolektive antiplumb;
- ç) Kaska balistike antiplumb;
- d) Kostum për mbrojtje nga mjetet e forta;
- dh) Mburoja "Policia";
- e) Kaska "Policia";
- ë) Shkop gome/metalik
- f) Pranga;
- g) Maska gazi;
- gj) Mjete optike (kamera, dylbi për ditë dhe natë);
- h) Pajisje kërkimi (metalkërkues, minakërkues, detektor);
- i) Blllokues rruge;
- j) Syze balistike;
- k) Mjete ndriçuese.